REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Notere: *ERNITA HAXHIU*
Nipti: *L61730017A*
Nr.690 Rep.
Nr.580 Kol.

Taksa e Pullës
U Pagua

**KONTRATË**
**SHITJE KUOTASH**

Sot, më datën 09 /11/2018 përpara meje Noteres Ernita Haxhiu, Notere e Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në Rr. "Kajo Karafili", Tiranë, u paraqitën personalisht, të cilët më kërkuan përpilimin e një Kontrate si më poshtë vijon:

**SHITËSI** :
**Z.Erald Sotiri**, atësia Flamur, lindur në Tirane, më date 19.10.1988 , banues në Tirane, madhor me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit ID nr. **I81019004H.**

Dhe

**BLERËSI :**
**Z.Bruno Osmani,** atësia Besim, i datëlindjes 08.06.1989, lindur në Tirane, banues në Tiranë, madhor me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportes me nr.**I90608003K**.

***Palet e mesiperme me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje kuotash si me poshte :***

**Shoqëria " SULA & LEO" shpk**, person juridik me NUIS – L71910501U, me seli në Durrës , Lgjja 14, Rr."Ish Ndermarrja e Serave", me përfaqësues ligjor **Z. Erald Sotiri.**

Shitesi, **Erald Sotiri** është zoterues me 100% te kapitalit te shoqerise " **SULA & LEO** " **shpk,** e cila eshte nje shoqeri tregtare shqiptare e regjistruar prane QKR me NIPT - **L71910501U.**
Kapitali i shoqerise eshte 100 lekë (njëqind), i zoteruar si me poshte :

- **Erald Sotiri,** zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 100 leke (njëqind), e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise.

**Objekti i kontrates**

Asambleja e ortakeve te shoqerise me vendimin e saj nr.05 date 06.11.2018, bazuar ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare dhe Statutit te Shoqerise, ka vendosur:

- Largimin nga shoqeria te ortakut **Z.Erald Sotiri.**

- **Transferimin nepermjet shitjes te 100 % te kapitalit te zoteruar nga ortaku, Erald Sotiri, tek Z.Bruno Osmani,** mbajtes i pasaportes me nr.personal J90608003K ***duke***

***u berë Ortak me 100% të kuotave*** në shoqerine " **SULA & LEO** " shpk, sipas dokumentacionit të kërkuar me ligj.

- Te miratoje pranimin ne Shoqeri te Ortakut te ri te vetëm **Z.Bruno Osmani.**

## ***Çmimi i shitjes***

Çmimi i shitjes se 100 % te kuotave, te cilat perfaqesojne 100 % te kapitalit te zoteruar nga ortaku **Erald Sotiri** dhe qe transferohet nepermjet kesaj kontrate ne favor te ortakut te ri **Z.Bruno Osmani** eshte per vleren **100,000 lekë**. *(njëqind mijë)*

Bleresi, **Z.Bruno Osmani,** ka paguar sipas paragrafit te mesiperm plotesisht çmimin e shitjes ne favor te **Erald Sotiri**, dhe shitesi deklaroi se e ka marre çmimin e plote te shitjes dhe nuk ka asnje pretendim.

***Garancite***
Shitesi deklaroi dhe garanton se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotave qe po transferohen nepermjet kesaj kontrate dhe se ato jane te lira nga çdo barre apo pretendim tjeter ligjor.

***Heqje dore nga te drejtat dhe detyrimet***
Shitesi deklaroi nen pergjegjesine e tij personale, se heq dore nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i takojne përkatësisht mbi 100 % te kuotave te zoteruara prej tij ne shoqerine " **SULA & LEO** " shpk.

***Te ndryshme***
Pas realizimit te ketij transferimi me nenshkrimin e kesaj kontrate Bleresi, **Z.Bruno Osmani,** behet pronar i vetem dhe i ligjshem, i 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise, ndersa shitesi zhvishet teresisht nga e drejta e pronesise mbi keto kuota dhe largohet nga shoqeria " **SULA & LEO** " shpk.

U Porositën Palët që një Kopje të kesaj kontrate ta dërgojnë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) .

Kjo kontrate u hartua ne kater ekzemplare me vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe palet deklaruan se jane dakort me sa me siper, dhe pasi e lexuan, e kuptuan, e nenshkruan regullisht perpara meje dhe une noterja, e vertetoj ate sipas ligjit.

**PALET**

| | |
|---|---|
| **SHITËSI** | **BLERËSI** |
| **Erald Sotiri** | **Bruno Osmani** |
| Erald Sotiri | Bruno Osmani |

**NOTERE**
**ERNITA HAXHIU**

Ernita Haxhiu

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20181106145039232 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 06.11.2018 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 2:50:39PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-498-163 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

ERALD FLAMUR SOTIRI
SULA & LEO SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE
R.B.S.
TIRANË - ALBANIA